

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetar kolegji dhe gjyqtarëve: Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit E.Gj., për shkak të veprës penale shmangie mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 298 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Doganor të Kosovës, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1834/12 të dt.22.09.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.1201/2017 të dt.01.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 30.04.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit E.Gj., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren -Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1834/12 të dt.22.09.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA.1nr.1201/2017 të dt.01.02.2018dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1834/12 të dt.22.09.2017, i dënuari E.Gj. është shpallur fajtor për veprën penale shmangie mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 298 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Doganor të Kosovës dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) €. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) €, kurse i dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA.1nr.1201/2017 të dt.01.02.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, kurse e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

## **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit E.Gj., av.Ethem Rugova nga Prizreni, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin ta liroj nga akuza ose ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se nga përshkrimi faktik i dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë del se në veprimet e të dënuarit nuk formohen tiparet e veprës penale shmangie mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 298 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Doganor të Kosovës, meqë nuk mund të vërtetohet se cili është objekti i veprës penale. Po ashtu, nga përshkrimi faktik i dispozitivit të aktgjykimit nuk vërtetohet personi që ka bërë veprimet inkriminuese dhe çfarë cilësie ka ky person e pastaj të vërtetohet përgjegjësia penale. I dënuari është njëri prej bashkëpronarëve të firmës NTP “E...”, mirëpo, drejtor është personi tjetër dhe gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar personin i cili ka bërë deklaram të rrejshëm.

Nuk është vërtetuar fakti vendimtar se dokumentacioni a ka ardhur bashkë me mallin apo deklarimi është bërë nga personat nga Turqia dhe më konkretisht, se deklamimin e rrejshëm e ka bërë i dënuari apo ndonjë person tjetër nga ana e NTP “E...”. Në këtë rast si provë kryesore ka shërbyer ekspertiza e ekspertit Bashkim Ibrahim i cili në ndërkohë ka vdekur dhe me këtë është pamundësuar parashtrimi i pyetjeve, kurse ekspertiza e ekspertit Q.S., nuk është shqyrtuar.

Më tutje në kërkesë pretendohet se shkeljet e aktgjykimit të shkallës së parë janë përsëritur edhe nga gjykata e shkallës së dytë, pasi që nuk janë dhënë arsyetimet për pretendimet ankimore por në mënyrë stereotipe dhe pa analizë dhe në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar se shkeljet e pretenduara të mbrojtësit të të dënuarit nuk qëndrojnë.

## **Mendimi i Prokurorit të Shtetit**

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.43/2018 të datës 20.03.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

## **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-ës dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

*kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoj se janë të bazuara pretendimet të paraqitura nga mbrojtësi i të dënuarit se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe atë për faktin se, aktgjykimi i shkallës së parë është kundërtëhënës me vetveten dhe arsyet e dhëna për arsye se aktgjykimi nuk përmban arsye të qarta për faktet vendimtare.

Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë ceket se i dënuari “... gjatë viteve 2008, 2009, 2010 dhe 2011, bën shmangie mashtruese nga taksat e importit apo akcizave që i nënshtrohen mallrave...”, por nuk ceket cilësia e të dënuarit në firmën NTP “...” me seli në Prizren. Në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë nuk është sqaruar fakti vendimtar meqë sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 22.09.2017 (faqe 7), sipas mbrojtjes së të dënuarit, por e konfirmuar edhe përmes certifikatës së biznesit me nr.të regjistrimit 80300557, i dënuari është një ndër pronarët e NTP “E...”, mirëpo rezulton se edhe dy persona tjerë janë bashkëpronar i kësaj firme dhe atë R.B., i cili është edhe drejtor i kësaj firme dhe M.M. Me këtë ka mbetur e paqartë rrethana se kush ishte importues i mallit nga Turqia, përkatësisht a ishte i dënuari apo bashkëpronarët e kësaj ndërmarrje apo të gjithë së bashku, meqë importi bazuar në dokumentacionin e importit rezulton se është bërë në emër të firmës NTP “E...” nga Prizreni.

Aktgjykimi i shkallës së parë po ashtu përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.12 të KPPK-së, meqë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.6 dhe 7 të KPPK-së.

Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsyetim për çdo pikë të aktgjykimit e po ashtu nuk ka arritur të arsyetoj se cilat fakte i konsideron të vërtetuara dhe cilat të pavërtetuara, sidomos mbrojtjen e të dënuarit dhe ekspertizën financiare. Po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar mbrojtjen e të dënuarit përkatësisht nuk ka arsyetuar faktin se cila ishte arsyeja që nuk i besoi mbrojtjes së tij sidomos në momentin e kryerjes së veprës penale dhe pretendimin e tij se si ka rrjedhur ngjarja.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përmban shkelje esenciale të dispozitës së procedurës penale nga neni 384 pa.1 nënpar.12 të KPPK-së dhe për këtë arsye u vendos që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe të administroj provat ekzistuese e sipas nevojës edhe prova tjera e pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penale juridike. Fillimisht duhet të përcaktoj me saktësi cilësinë e të dënuarit në ndërmarrjen “E...” dhe rolin e dy bashkëpronarëve të kësaj firme dhe faktin se kush ishte personi që importoj mallrat që pretendohen se janë importuar kurse me këtë rast janë shmangur pagesat e detyrimeve për import dhe akciza.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.62/2018, më datë 30.04.2018

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka